



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 24.02.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje ushqime për QEA (ndarë në 5 Lote)”

- **Loti I** – *“Blerje mish dhe nënprodukte të tij”*
- **Loti II** – *“Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij”*
- **Loti III** – *“Blerje bukë” (bukë gruri, thekre dhe integrale)*
- **Loti IV** – *“Blerje artikuj ushqimor kolonial” (ambalazhuar/paketuar)*
- **Loti V** – *“Blerje fruta dhe zarzavate”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

15894210-6 - Ushqime për shkollë.

VLERA E FONDIT LIMIT:

87,211,000 (tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë) Lek pa TVSH ose **905,712** (nëntëqind e pesë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) Euro pa TVSH, i ndarë në 5 lote si më poshtë vijon:

Loti I – *“Blerje mish dhe nënprodukte të tij”* - me **fond limit 12,311,825** (dymbëdhjetë milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) Lek pa TVSH ose **127,862** (njëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH.

Loti II – *“Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij”* - me **fond limit 32,375,825** (tridhjetë e dy milion e treqind shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) Lek pa TVSH ose **336,232** (treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) Euro pa TVSH.

Loti III – *“Blerje bukë” (bukë gruri, thekre dhe integrale)* - me **fond limit 5,915,576** (pesë milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH ose **61,435** (gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

Loti IV – *“Blerje artikuj ushqimor kolonial” (ambalazhuar/paketuar)* - me **fond limit 13,009,605** (trembëdhjetë milion e nëntë mijë e gjashtëqind e pesë) Lek pa TVSH ose **135,109** (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntë) Euro pa TVSH.

Loti V – “Blerje fruta dhe zarzavate” - me fond limit 23,598,169 (njëzet e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Lek pa TVSH ose 245,074 (dyqind e dyzet e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 24.02.2026 ora 12:02:36, me kurs këmbimi 96.29 Lek.

Argumentimi:

Në vijim të Urdhërit nr.59, datë 13.02.2026, protokolluar nr.2224 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për QEA” (e ndarë në 5 Lote), grupi i punës, pasi u njoh me objektin e prokurimit, e filloi punën për hartimin e dokumentacionit duke pasqyruar në të dhe ndryshimet përkatëse.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Vendimin nr.73, datë 23.12.2025 të Këshillit Bashkiak, Bashkia Durrës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimine buxheti të Bashkisë Durrës për vitin 2026”.
2. Dokumentat lidhur me preventivin dhe specifikimet teknike, të hartuar nga grupi i punës në Bashkinë Durrës.

PËRLLLOGARITJA E VLERËS SË FONDIT LIMIT:

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si edhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin nr.73, datë 23.12.2025 të Këshillit Bashkiak, Bashkia Durrës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimine buxheti të Bashkisë Durrës për vitin 2026”.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*

a) *çmimet e tregut; ose/dhe*

b) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Grupi i punës realizoi punë kërkimore mbi çmimet orientuese për mallrat, të cilat janë objekt prokurimi, duke u bazuar në çmimet e INSTAT-it, hetimin e tregut vendas si dhe kontratat e mëparshme, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, u testua tregu në 3 subjekte (të dhënat e çmimeve gjenden të administruar në dosje ne një rprocverbal) si dhe çmimet e kontratave të mëparshme bazuar dhe në VKM-në 835, datë 30.11.2022 “Për miratimin e rregullores për kërkesat higjeno-sanitare të pishinave”.

Në fund të procesit u siguruan çmimet e vlerësuar për mallin, objekt i këtij prokurimi. Pas përlllogaritjes së preventivit të hartuar nga grupi i punës, pas studimit të tregut, vlera e përgjithshme (pë 5 lotet) rezulton të

jetë: **87,211,000** (tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë) Lek pa TVSH ose **905,712** (nëntëqind e pesë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) Euro pa TVSH, i ndarë në 5 lote si më poshtë vijon:

Loti I – “Blerje mish dhe nënprodukte të tij” - me **fond limit 12,311,825** (dymbëdhjetë milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) Lek pa TVSH ose **127,862** (njëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH.

Loti II – “Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij” - me **fond limit 32,375,825** (tridhjetë e dy milion e treqind shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) Lek pa TVSH ose **336,232** (treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) Euro pa TVSH.

Loti III – “Blerje bukë” (bukë gruri, thekre dhe integrale) - me **fond limit 5,915,576** (pesë milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH ose **61,435** (gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

Loti IV – “Blerje artikuj ushqimor kolonial” (ambalazhuar/paketuar) - me **fond limit 13,009,605** (trembëdhjetë milion e nëntë mijë e gjashtëqind e pesë) Lek pa TVSH ose **135,109** (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntë) Euro pa TVSH.

Loti V – “Blerje fruta dhe zarzavate” - me **fond limit 23,598,169** (njëzet e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Lek pa TVSH ose **245,074** (dyqind e dyzet e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 24.02.2026 ora 12:02:36, me kurs këmbimi 96.29 Lek.

Afati Kohor dhe Garancitë e Produkteve

Për realizimin dhe zbatimin e kontratës afati do të jetë deri në përfundimin e sasisë, furnizimi do të kryhet pas çdo kërkesë të QEA-së në magazinën e Qendres Ekonomike të Arsimit Durrës.

Afatet e lëvrim: Deri në përfundimin e sasisë.

Kohëzgjatja e kontratës: 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndyshuar, VKM 291 dt 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, e Ligjit nr 10296 “dt 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKB nr.73, dt 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028” dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026”, autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT LOTI I - “BLERJE MISH DHE NËNPRODUKTE TË TIJ”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 1. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit” dhe nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllëgojës të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është midis kufirit të ulët monetar dhe kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e parë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkojnë një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit", si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.", si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin

ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr.285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licencë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit:

Për OE/BOE :

Licenca të jetë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të OE të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz,

referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas *Shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit*, ku të deklarojë se disponon mjet transporti ATV frigoriferik, ne pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATV frigoriferik, te vertetuar me:

- *leje qarkullimi,*
- *certifikatë pronësie*
- *siguracion (TPL)*
- *certifikatë e kontrollit teknik*
- *certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton)*

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura, në rastin kur mjeti është në përdorim sipas kontrates noteriale, OE duhet të paraqesë kontratën noteriale përkatëse, si dhe për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton, certifikata e transportit të mallrave duhet të rezultojë për përdorim nga të tretët.

Argumentimi: *Arsyeja përse është kërkuar automjeti ATV është bërë duke marrë parasysh kushtet në të cilat duhet të kryhet transporti i i produkteve të këtyre loteve. Duke iu referuar Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, për transportin e këtyre produkteve kërkohen kushte frigoriferike, për rrjedhojë, automjetet kërkohet të jenë frigoriferikë, d.m.th ATV.*

Gjithashtu për mjetet e transportit mbi 1.5 referuar ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “për transportet rrugore”, i ndryshuar, nevojitet pajisja me certifikatë transporti mallrash. Ndërsa referuar Njoftimit të APP nr. 4916/2 prot., datë 14.07.2022 certifikata e transportit të mallrave për mjete të marra në përdorim duhet të jetë për përdorim nga të tretët.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambient të përshtatshëm për therjen, tregetimin dhe magazinimin e produkteve të mishit të pajisur me leje higjeno-sanitare, të leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, për të cilin duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira të objektit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambientit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambientit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 të App dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” pasi gjykohet e nevojshme nga AK për të siguruar në cilësinë e mallit që ofron Operatori Ekonomik si dhe një furnizim në vijimesi e të vazhdueshëm. Ambienti duhet të plotësojë kushtet higjeno sanitare dhe tekniko teknologjike, vërtetuar kjo nga organet kompetente*

në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet përkatëse në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Për OE/BOE :

Vetdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të AKU në periudhën e vetdeklarimit.

Argumentim: *Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr.10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.*

2.3.6 Nëse Operatori Ekonomik oferton në më shumë se një lot, atëherë duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar është bazuar në nenin 42, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu kjo kërkesë i referohet rekomandimit të APP nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, ku përcaktohet që nëse OE ofertojnë në më shumë se një lot, duhet ti provojnë AK se disponojnë aftësitë teknike dhe gjendjen ekonomike /financiare për realizimin e të gjitha objekteve të loteve ku kanë marrë pjesë nëse ato shpallen fitues.*

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 3(tre) punonjës në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, për të cilët ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Kontratë pune, librezë shëndetsore dhe për njërin nga punonjësit duhet të paraqesë edhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.

Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 1 shofer, 2 punetorë të thjeshtë

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e nevojave për furnizimin e vazhdueshëm, të përditshëm e të pandërprër të QEA me artikujt objekt prokurim. Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 1 shofer, 2 punetorë të thjeshtë.*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë/disponojë:

- a. Certifikatë ISO 9001 ose ekuivalente me të, të vlefshme. *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë; Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1, 2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar Pajisjen e operatorit ekonomik me certifikatën 9001, për të vërtetuar se mallrat, si objekt i këtij prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe shpreh garancinë për to. Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë të tij.*

- b. Certifikatë ISO 22000 ose ekuivalente me të, të vlefshme. Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.

Argumentimi: *Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të siguri së ushqimore. Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr.10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.*

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”:“..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT LOTI II- ”BLERJE BULMET DHE NËNPRODUKTE TË TIJ”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen*

e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 2. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit” dhe nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit të tretë me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar se “Vlera e xhiros

minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes

vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë licencë nga Qendra Kombetare e Licencimit për produktet me origjinë shtazore:

- Licencë të kategorisë II.1.A.1 - “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” për objektin e prokurimit bulmet dhe nenproduktet e tij dhe
- Licencë të Kategorisë II.1.B - “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz”.

(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në piken 5 /a të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se: 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale,

autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket te APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e licences eshte kerkuar per te vertetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet te rregullt ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per fushen e sigurise ushqimore dhe mbrojtjes se konsumatorit. Ky kriter eshte vendosur me qellim qe ti sherbeje AK per te siguruar per cilesine e ushqimit per femijet e kopshteve dhe cerdheve qe jane ne kujdesin dhe pergjegjesine e autoritetit kontraktor.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas *Shtojcës 9* të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjet transporti ATV frigoriferik, ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATV frigoriferik, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- certifikatë pronësie
- siguracion (TPL)
- certifikatë e kontrollit teknik
- certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton)

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura, në rastin kur mjeti është në perdorim sipas kontrates noteriale, OE duhet të paraqesë kontratën noteriale përkatëse, si dhe për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton, certifikata e transportit të mallrave duhet të rezultojë për përdorim nga të tretët.

Argumentimi: Arsyeja përse është kërkuar automjeti ATV është bërë duke marrë parasysh kushtet në të cilat duhet të kryhet transporti i produkteve të këtyre loteve. Duke iu referuar Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, për transportin e këtyre produkteve kërkohen kushte frigoriferike, për rrjedhojë, automjetet kërkohet të jenë frigoriferikë, d.m.th ATV.

Gjithashtu për mjetet e transportit mbi 1.5 referuar ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “për transportet rrugore”, i ndryshuar, nevojitet pajisja me certifikatë transporti mallrash. Ndërsa referuar Njoftimit të APP nr. 4916/2 prot., datë 14.07.2022 certifikata e transportit të mallrave për mjete të marra në përdorim duhet te jetë për përdorim nga të tretë.

2.3.4 Operatori e Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira ose perdorim të objektit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira ose perdorim. Kontrata duhet të jenë noteriale dhe të jenë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambienti duhet të plotësojë kushtet higjieno sanitare dhe teniko teknologjike, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambientit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambientit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 të App dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” pasi gjykohet e nevojshme nga AK për të siguruar në cilësinë e mallit që ofron Operatori Ekonomik si dhe një furnizim në vijimesi e të vazhdueshëm.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë furnizimi me një subjekt prodhues të vezëve për të siguruar furnizim të vazhdueshëm me këte artikull.

Lidhur me këtë pikë të paraqitet Kontrata e furnizimit noteriale si dhe licenca me kodin II.1.A.1 e prodhuesit të vezëve.

Argumentim: Për të siguruar furnizim të pandërprerë me artikullin “Vezë” si dhe nisur nga situata ciklike e gripit të shpendeve është e domosdoshme vendosja e një kriteri të tillë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet përkatëse në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Për OE/BOE:

Vetdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të AKU në periudhën e vetdeklarimit.

Argumentim: Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr.10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

2.3.7 Nëse Operatori Ekonomik oferton në më shumë se një lot, atëherë duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar është bazuar në nenin 42, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu kjo kërkesë i referohet rekomandimit të APP nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, ku përcaktohet që nëse OE ofertojnë në më shumë se një lot, duhet ti provojnë AK se disponojnë aftësitë teknike dhe gjendjen ekonomike /financiare për realizimin e të gjitha objekteve të loteve ku kanë marrë pjesë nëse ato shpallen fitues.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas *shtojcës 9* të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 3(tre) punonjës në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, për të cilët ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Kontratë pune, librezë shëndetsore dhe për njërin nga punonjësit duhet të paraqesë edhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.

Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 1 shofer, 2 punëtorë të thjeshtë.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e nevojave për furnizimin e vazhdueshëm, të përditshëm e të pandërprër të QEA me artikujt objekt prokurim. Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 1 shofer, 2 punëtorë të thjeshtë.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë/disponojë:

- a. Certifikatë ISO 9001 ose ekuivalente me të, të vlefshme. Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë; Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1, 2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar Pajisjen e operatorit ekonomik me certifikatën 9001, për të vërtetuar se mallrat, si objekt i këtij prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe shpreh garancinë për to. Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë së tij. Pajisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

- b. Certifikatë ISO 22000 ose ekuivalente me të, të vlefshme. Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.

Argumentimi: Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr.10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”：“..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

3. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT **LOTI III – “BLERJE BUKË”** **(GRURI, THEKRE DHE INTEGRALE)**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % vlerës së fondit limit të lotit 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore

dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e tretë është nën kufirin të që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapu e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik,

të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 e VKM nr.285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit limit të këtij loti është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e

thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licencë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit:

Për OE/BOE:

Licenca të jetë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:

Kategoria: II.1 *”Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve”.*

Nënkategoria: II.1.A.1. *”Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, për objektin e prokurimit për prodhimin dhe tregëtimin e bukës*

Licenca duhet të jetë në emër të OE të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet.*

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas *Shtojcës 9* të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjet transporti ATP, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATP, të vërtetuar me:

- leje qarkullimi,
- certifikatë pronësie
- siguracion (TPL)
- certifikatë e kontrollit teknik
- certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton)

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura, në rastin kur mjeti është në përdorim sipas kontratës noteriale, OE duhet të paraqesë kontratën noteriale përkatëse, si dhe për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton, certifikata e transportit të mallrave duhet të rezultojë për përdorim nga të tretët.

Argumentimi: Për mjetet e transportit mbi 1.5 referuar ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”, i ndryshuar, nevojitet pajisja me certifikatë transporti mallrash. Ndërsa referuar Njoftimit të APP nr. 4916/2 prot., datë 14.07.2022 certifikata e transportit të mallrave për mjete të marra në përdorim duhet të jetë për përdorim nga të tretët.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira, furre buke, për prodhimin ose magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi. Ambienti duhet të plotësojë kushtet higjieno sanitare dhe tekniko teknologjike, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *“Për*

inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar dhe të jete i pajisur me:

- Aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira të objektit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.
- Leje higjeno- sanitare lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj;
- Licence me kodin II.1.A.1;
- Certifikatë për mbrojtjen ndaj zjarrit dhe shpëtimi e lëshuar nga SHMZSH, e cila të jetë e vlefshme në momentin e ofertimit, për objektin e sipërcituar i cili mund të jetë në pronësi ose me qira.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambientit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambientit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe Rekomandimin eperbashket date 19.11.2018 te APP dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” pasi gjykohet e nevojshme nga AK për të siguruar në cilësinë e mallit që ofron Operatori Ekonomik si dhe një furnizim në vijimesi e të vazhdueshëm.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet përkatëse në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Për OE/BOE:

Vetdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të AKU në periudhën e vetdeklarimit.

Argumentim: Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr.10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

2.3.6 Nëse Operatori Ekonomik oferton në më shumë se një lot, atëherë duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar është bazuar në nenin 42, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu kjo kërkesë i referohet rekomandimit të APP nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, ku përcaktohet që nëse OE ofertojnë në më shumë se një lot, duhet të provojnë AK se disponojnë aftësitë teknike dhe gjendjen ekonomike /financiare për realizimin e të gjitha objekteve të loteve ku kanë marrë pjesë në ato shpallen fitues.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas *shtojcës 9* të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 4 (katër) punonjës në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, nga të cilët 1 shofer, 1 punëtor ndihmës, dhe 2 brumëgatues buke, për të cilët ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Kontratë pune, librezë shëndetsore dhe për punonjësin shofer duhet të paraqesë edhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.

Ky kriter permbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e nevojave për furnizimin e vazhdueshëm, të përditshëm e të pandërprër të QEA me artikujt objekt prokurim. Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 1 shofer, 1 punëtor ndihmës, dhe 2 brumëgatues buke.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë/disponojë:

- a. Certifikatë ISO 9001 ose ekuivalente me të, të vlefshme. *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë; Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1, 2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar Pajisjen e operatorit ekonomik me certifikatën 9001, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

- b. Certifikatë ISO 22000 ose ekuivalente me të, të vlefshme. Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.

Argumentimi: Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”:“..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta

ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

4. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT **LOTI IV: “BLERJE ARTIKUJ USHQIMOR KOLONIAL”** **(AMBALAZHUAR/PAKETUAR)**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 4. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet

dokumente të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit” dhe nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlogarit të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është midis kufirit të ulët monetar dhe kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e parë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohej një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku

subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter permbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

